



Prishtinë: 29.03.2018

Kodi i ZRRE-së: V_961_2018

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1707_10_17**;
- Ankesa e konsumatorit e datës **03.11.2017**.

në seancën e mbajtur më datë 29.03.2018, nxori këtë:

V E N D I M

- I **REFUZOHET** ankesa e konsumatorit F.G., nga Prishtina me shifër DPR 90025491 si e pa bazuar.
- II **MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. **ZRRE/DMK_V_1707_10_17** i datës 11.10.2017.

A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 03.11.2017 ka pranuar ankesën e parashtruar nga konsumatori F.G, i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE si vendim i shkallës së parë për këto shkaqe: vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkëlqes së të drejtës materiale, dhe vendimit mbi borxhin e energjisë elektrike. Konsumatori në ankesë ka theksuar se në vendimin e atakuar nuk është vërtetuar saktë gjendja faktike, pasi shpenzimet e ngarkuara janë të pabazuara. Konsumatori në ankesë ka theksuar se duhet të analizohen të gjitha shpenzimet, pasi shpenzimi i ngarkuar është paushall dhe jo i drejtë.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 29.03.2018 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve, dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Bordi i ZRRE-së, ka analizuar dhe shqyrtuar me kujdes të gjitha pretendimet ankimore të konsumatorit të theksuara në ankesë, por që nuk ka vërtetuar me asnjë element se konsumatori është i dëmtuar dhe ngarkuar me ndonjë vlerë financiare më tepër se sa shpenzimi i energjisë elektrike të bërë në këtë pikë matëse.

Bordi ka analizuar edhe të gjitha konstatimet e theksuara nga shkalla e parë lidhur me gjendjen e shpenzimit të energjisë elektrike dhe me këtë ka vërtetuar se gjendja e shpenzimit të energjisë elektrike e njehsorit elektrik nr.63988233 ku TL=024748 kWh dhe TU=015295 kWh e evidentuar n



procesverbalin nr.1394490 të datës 07.12.2015 është në përputhje me gjendjen e shpenzimit të energjisë elektrike të evidentuar në rrjedhën e energjisë elektrike për muajin 11/2015.

Bordi ka analizuar edhe pikën tjetër të kundërshtimit ku theksohet se nuk janë analizuar shpenzimet e mëhershme, pasi shpenzimi i ngarkuar nuk është i drejtë. Lidhur me këtë Bordi i ZRRE-së ka analizuar me kujdes vendimin e shkallës së parë dhe rrjedhën e energjisë elektrike ku janë të paraqitura shpenzimet e konsumatorit dhe konstaton se organi i shkallës së parë ka analizuar shpenzimet e energjisë elektrike me dy njehsorët elektrik për periudha të njëjta kohore dhe se është konstatuar se konsumatori me njehsorin kontestues nr.63988233 ka pasur shpenzim të njëjtë si me njehsorin elektrik nr. 04659610. Shpenzimi i energjisë elektrike me njehsorin elektrik nr.04659610 për periudhën 02/2014 deri në periudhën 12/2014 mesatarja mujore e shpenzimit është **3,842 kWh/muaj**, kurse me njehsorin elektrik kontestues nr.63988233 per periudhën 02/2015 deri në periudhën 12/2015 mesatarja mujore e shpenzimit është **3,815 kWh/muaj**.

Gjithashtu duhet theksuar se të dy njehsorët nr.04659610 dhe nr.63988233 janë dërguar në qendrën e kalibrimit për shqyrtim të saktësisë dhe konstaton se gabimi në matje te njehsorët në fjalë është brenda kufijve të lejuar matës me çka edhe vërtetohet se dy njehsorët elektrik të konsumatorit kanë bërë matje të saktë. Pra, në asnjërin nga protokollet e shqyrtimit të saktësisë së matjes së njehsorëve nuk është evidentuar që njehsorët elektrik janë të dëmtuar në çfarëdo forme.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 29.03.2018 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimet të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i Rregullatorit:

Arsim Janova, u.d. kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Konsumatorit F. G. dhe
- KESCO-së, dhe
- Arkivit të ZRRE-së